



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI

Nr. 963 Prot.

Tiranë, më 30.03 .2023

VENDIM

Nr. 80 , datë 30.03.2023

PËR

ORGANIZIMIN E SEANCAVE TË DHURIMIT VULLNETAR TË GJAKUT NË
NDIHMË TË FËMIJËVE TALASEMIKË NË UST

Mbështetur në shkresën e Kryqit të Kuq Kombëtar nr. 168 datë 21/02/2023
"Kërkesë në ndihmë të fëmijëve talasemikë për realizimin e një seance dhurimi vullnetar të gjakut",

VENDOSA:

1. Organizimin në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Kombëtar të seancave të dhurimit vullnetar të gjakut në ndihmë të fëmijëve talasemikë në datat 3-4-5 Prill 2023 pranë auditorit A9 në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
2. Ngarkohet Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes për marrjen e masave për zhvillimin e mësimit të parashikuar pranë A9, në këto data, në ndonjë auditor tjetër të universitetit.
3. Komisioni i Marrëdhënieve me Studentët në bashkëpunim me njësitë kryesore të universitetit të realizoj fushata sensibilizuese për dhurimin vullnetar të gjakut pranë stafit dhe studentëve të UST.
4. Ngarkohet Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët për marrjen e të gjitha masave për organizimin, sensibilizimin dhe promovimin e këtij aktiviteti tek stafi dhe studentët.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof.Dr. Agron KASA



Konceptoi: Msc. Safiola Çarçani
Numri i kopjeve origjinale: 3 (tre)